

# Gjuha

Në kantonin Aargau, banorët që nuk flasin gjermanisht pritet të mësojnë gjermanisht. Njohuritë gjuhësore janë parakushti kryesor për integrim të suksesshëm në shoqëri dhe në tregun e punës.

## Gjuha letrare gjermane / gjermanishtja zvicerane

Zvicra ka katër gjuhë vendore: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retoromanisht. Në kantonin Aargau gjuhë zyrtare është gjermanishtja. Ka dallim në mes të gjuhës letrare gjermane (Hochdeutsch) dhe gjermanishtës zvicerane (Schweizerdeutsch).

Gjermanishtja letrare flitet në shkollë dhe pjesërisht edhe në radio dhe televizion. Po ashtu shkrimi bëhet në gjuhën letrare gjermane. Ndërkaq në përditshmëri flitet gjermanishtja zvicerane. Kjo është një dialekt i gjermanishtes, që edhe për njerëzit me njohuri të mira të gjuhës gjermane, nuk është gjithnjë e thjeshtë të kuptohet. Nuk pritet që të huajt dhe të huajt të flasin gjermanishten zvicerane, por pas një kohe të caktuar ta kuptojnë. Mund t'u kërkohet zviceranëve të flasin gjuhen letrare gjermane.

## Gjermanishtja dhe fëmijët

Rekomandohet që fëmijët që flasin gjuhë tjera, të vihen në kontakt sa më herët që është e mundur me fëmijë që flasin gjuhën gjermane. Grupet për lojëra apo ofertat e veçanta për prindër dhe fëmijë janë ideale për këtë. Prindërit gjithashtu mund t'i mbështesin fëmijët e tyre duke folur shumë me ta, duke i dëgjuar ata, dhe duke u treguar histori. Ata duhet ta bëjnë këtë në gjuhën që dinë më së miri dhe që është më afër tyre.

## Përkthimet

Nuk mund të pritet, që dikush menjëherë pas ardhjes së tij të kuptoj dhe të flas mirë gjermanisht. Megjithatë ka sitata, në të cilat njeriu duhet të kuptojë. Shumë të ardhur të rinjë i lusin të afërmit apo të njohurit për t'u përkthyer. Në biseda të komplikuara personale ose të besueshme njeriu ndoshta dëshiron ta ketë një përkthyese apo përkthyes profesionist. Përkthyeset dhe përkthyesit ndërkulturorë janë të specializuar për këtë dhe janë të kujdeshshëm lidhur me veçoritë kulturore gjatë përkthimit. Në të kuptuarit dhe shkruarit e letrave si dhe në plotësimin e formularëve, ju ndihmon Shërbimi për Shkresa (Schreibdienst) i Kryqit të Kuq Zviceran (SRK) në Aarau apo Baden.

## Më shumë informacione ([link](#), [adresa](#), [broshura](#), [fletushka](#))

[www.zdravo-aargau.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/gjuha](http://www.zdravo-aargau.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/gjuha)